Instituti i Statistikave
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017

info@instat.gov.al
www.instat.gov.al
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2222 411

# Statistikat e transportit*

## Shtator 2020

**Tiranë, më 27 Tetor 2020:** Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Shtator 2020 është 366 mijë ton, duke u ulur 7,7 %, krahasuar me Shtator 2019.

Në nëntëmujorin e vitit 2020, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 3.094 mijë ton, duke u ulur me 9,4 %, krahasuar me nëntëmujorin e vitit 2019.

Në muajin Shtator 2020, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 2.291 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 44,3 %, krahasuar me Shtator 2019.

Në nëntëmujorin e vitit 2020, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 18.624 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 40,5 %, krahasuar me nëntëmujorin e vitit 2019.

**Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër**

| Periudha | Me det/ton | Hekurudhë 000/ton.km | Ajër/ton* |
|---|---|---|---|
| Shtator 2019 | 396.407 | 4.110 | 184,6 |
| Shtator 2020 | 365.740 | 2.291 | 159,4 |
| **Ndryshimi vjetor (%)** | **-7,7** | **-44,3** | **-13,6** |
| Janar-Shtator 2019 | 3.416.558 | 31.301 | 1.708,4 |
| Janar-Shtator 2020 | 3.094.081 | 18.624 | 1.304,3 |
| **Ndryshimi vjetor (%)** | **-9,4** | **-40,5** | **-23,7** |

** Përfshin mallrat dhe postën*

***Burimi**: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT*

Në muajin Shtator 2020, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 159,4 ton, duke u ulur me 13,6 %, në krahasim me Shtator 2019.

Në nëntëmujorin e vitit 2020, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 1.304,3 ton duke u ulur me 23,7 %, krahasuar me nëntëmujorin e vitit 2019.

Në Shtator 2020, numri i fluturimeve të kryera është 1.696 duke shënuar një rënie me 39,1 %, në krahasim me Shtator 2019.

**Për publikim 27/10/2020**

*Vijon*

* Ky publikim nuk përfshin volumin e mallrave dhe numrin e pasagjerëve të transportuar nëpërmjet transportit rrugor.

### Tab. 2 Treguesit e transportit ajror

| Periudha | Numri i shoqërive ajrore* | Numri i fluturimeve | Numri i mbikalimeve |
|---|---|---|---|
| Shtator 2019 | 20 | 2.786 | 20.388 |
| Shtator 2020 | 16 | 1.696 | 11.105 |
| **Ndryshimi vjetor (%)** | **-20,0** | **-39,1** | **-45,5** |
| Janar- Shtator 2019 | 20 | 21.885 | 150.675 |
| Janar- Shtator 2020 | 16 | 11.478 | 69.448 |
| **Ndryshimi vjetor (%)** | **-20,0** | **-47,6** | **-53,9** |

*****Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat në fillim të vitit janë licensuar të kryejnë fluturime

***Burimi**: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT*

Në Shtator 2020, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 27.501 pasagjerë. Krahasuar me Shtator 2019, ky tregues është ulur 84,6 %. Në nëntëmujorin e vitit 2020, kanë udhëtuar me linjë detare 295.066 pasagjerë, duke u ulur me 78,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në muajin Shtator 2020, transporti ajror i pasagjerëve zë 81,9 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në nëntëmujorin e vitit 2020 është 1.043.457 pasagjerë duke u ulur me 59,3 %, krahasuar me nëntëmujorin e 2019.

### Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

| Periudha | Transporti i pasagjerëve | | |
|---|---|---|---|
| | Me hekurudhë | Me det | Me ajër |
| Shtator 2019 | 3.973 | 178.774 | 340.282 |
| Shtator 2020 | 841 | 27.501 | 127.813 |
| **Ndryshimi vjetor (%)** | **-78,8** | **-84,6** | **-62,4** |
| Janar- Shtator 2019 | 56.385 | 1.340.840 | 2.562.311 |
| Janar- Shtator 2020 | 16.312 | 295.066 | 1.043.457 |
| **Ndryshimi vjetor (%)** | **-71,1** | **-78,0** | **-59,3** |

***Burimi**: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT*

### Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Shtator 2020, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 77,6 mld lekë dhe 48,2 % e tyre u transportua me det.

Në nëntëmujorin e vitit 2020, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 623,2 mld lekë dhe 49,9 % e tyre u transportua me det.

## Eksportet e mallrave

Në Shtator 2020, mallrat e eksportuara me det zënë 56,1 %, me rrugë 42,4 % dhe me ajër 0,6 %. Mallrat e eksportuara me rrugë në Shtator 2020 janë rritur me 17,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

**Tab.4 Eksporti i mallrave sipas mënyrave të transportit**

| Periudha | Eksport (mln lekë) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Me det | Me hekurudhë | Me rrugë | Me ajër | Të tjera |
| Shtator 2019 | 15.287 | - | 9.130 | 103 | 420 |
| Shtator 2020 | 14.170 | 2 | 10.691 | 143 | 236 |
| **Ndryshimi vjetor (%)** | **-7,3** | **-** | **17,1** | **39,5** | **-43,9** |
| Janar-Shtator 2019 | 133.002 | 4 | 87.755 | 1.087 | 3.270 |
| Janar-Shtator 2020 | 109.059 | 5 | 82.033 | 856 | 2.634 |
| **Ndryshimi vjetor (%)** | **-18,0** | **14,7** | **-6,5** | **-21,3** | **-19,5** |

***Burimi:*** *Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT*

Në nëntëmujorin e vitit 2020, mallrat e eksportuara me det zënë 56,0 %, me rrugë 42,2 % dhe me ajër 0,4 %. Mallrat e eksportuara me rrugë janë ulur 6,5 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

**Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Shtator 2020**




***Burimi:*** *Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT*

## Importet e mallrave

Në Shtator 2020, mallrat e importuara me det zënë 44,3 %, me rrugë 48,6 % dhe me ajër 3,3 %. Mallrat e importuara me rrugë në Shtator 2020 janë rritur me 7,8 %, krahasuar me Shtator 2019.

## Tab.5 Importi i mallrave sipas mënyrave të transportit

| Periudha | Import (mln lekë) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Me det | Me hekurudhë | Me rrugë | Me ajër | Të tjera |
| Shtator 2019 | 24.931 | 311 | 23.583 | 1.676 | 1.685 |
| Shtator 2020 | 23.199 | 245 | 25.434 | 1.720 | 1.754 |
| **Ndryshimi vjetor (%)** | **-6,9** | **-21,2** | **7,8** | **2,6** | **4,1** |
| Janar-Shtator 2019 | 234.680 | 3.345 | 208.735 | 14.851 | 19.699 |
| Janar-Shtator 2020 | 201.966 | 2.163 | 201.009 | 12.501 | 11.015 |
| **Ndryshimi vjetor (%)** | **-13,9** | **-35,3** | **-3,7** | **-15,8** | **-44,1** |

Në nëntëmujorin e vitit 2020, mallrat e importuara me det zënë 47,1 %, me rrugë 46,9 % dhe me ajër 2,9 %. Mallrat e importuara me rrugë janë ulur me 3,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

## Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Shtator 2020




***Burimi**: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritjet të INSTAT*

# Metodologji

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve, sipas llojeve, si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit, në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Përkufizime

**Transport:** Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

**Transporti hekurudhor**: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

**Transport detar**: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

**Transport ajror**: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

**Eksportet j**anë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

**Vlera F.O.B:** Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

**Importet** janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

**Vlera C.I.F**: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri ne kufirin e vendit që importon mallrat.

**Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007)** është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

*Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shum,ë referohu: Politika e Revizionimit Statistikor.*

### Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash